



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.162/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Skualifikimi i BOE “Infra Plan & Archistudio” shpk dhe “Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk nga procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me nr.REF-48358-01-28-2020 me objekt “*Projektim, për rikualifikimin e Zonës Bregdetare Vlorë - Radhimë - Orikum, Loti III*”, me fond limit 53,943,848 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: BOE “Gjeokonsult&Co” shpk& “Archispace” shpk
Rruga “Sami Frashëri”, Pallati 45, Shkalla 01, Kati II,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.3 Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik .

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.01.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me nr.REF-48358-01-28-2020 me objekt “*Projektim, për rikualifikimin e Zonës Bregdetare Vlorë - Radhimë - Orikum, Loti III*”, me fond limit 53,943,848 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr.852/1 datë 29.04.2020 rezulton se në datën 20.02.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk
- BOE Seed Consulting shpk& Kejsi-05 shpk& “Atelier 4” shpk

II.3. Në datën 02.03.2020 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk
- BOE Seed Consulting shpk& Kejsi-05 shpk& “Atelier 4” shpk

II.4. Në datën 01.04.2020 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike ku kanë marrë pjesë ofertueit si më poshtë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk

II.5. Në datën 07.04.2020 BOE “Gjeokonsult&Co” shpk& “Archispace” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, me pretendimet si më poshtë:

- *Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor konkretisht atij administrativ në këtë rast për një konkurim të ndershëm dhe transparent (neni 2 i LPP) na lind e drejta dhe ndjejmë detyrimin njëkohësisht që tju vëmë në duke disa shkelje të cilat i kemi konstatuar nga shoqëritë që kanë kaluar fazën e parë por cuditërisht nuk janë skualifikuar.*
- *Duke qenë se kjo procedurë përbëhet nga dy faza ankesa jonë është me vend të ndalet në këtë fazë që jemi për të parandaluar zgjedhjen e subjekteve që nuk duhet të jenë në vijim për shkak të kriterëve ligjore.*
- *Konkretisht gjatë fazës së dytë në hapjen e zarfave të propozimit teknik u mbajt një procesverbal në të cilin kanë nënshkruar të gjithë ata që kanë qenë prezent ndër to edhe përfaqësuesi i BOE Gjeokonsult&Co shpk& Archispace shpk.*

- Nga vëzhgimi i përgjithshëm i procesverbalit dhe i gjithë procedurës në tërësi konsatojmë dy shkelje të një rëndësie të vecantë.
- Së pari në DT e publikuara nga FSHZH një ndër kriteret kryesore të cilat kanë të bëjnë me dokumentacionin është kushti që dokumentat duhet të jenë të noterizuara. Nga konstatimi direkt i përfaqësuesit tonë në hapjen e zarfave është vënë re se dokumentat e BOE Infra Plan JV Archistudio nuk janë të noterizuar. Si dhe në procesverbal nga analiza e të gjithë subjekteve pjesmarrës rezulton se për të gjitha shoqëritë e tjera është e shkruar kur kanë depozituar dokumente të noterizuar ndërsa konkretisht te kjo shoqëri nuk është cituar një gjë e tillë pasi në të vërtetë nuk i ka patur të noterizuar. Ky fakt duhet të kishte bërë shkak për skualifikim dhe nuk duhet të vijoje më tej ky bashkim operatorësh.
- Në VKM nr 914 i ndryshuar konkretisht në nenin 57 personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit është e parashikuar shumë qartë detyrimi i kësaj strukture për të kërkuar dokumente origjinalë ose kopje të noterizuar si dhe për rrjedhojë këtë detyrim duhet ta përmbushin operatorët të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë. Ky është një shkak thelbësor dhe që normalisht duhet të ishte evidentuar që në momentin e parë që njësia e prokurimit publik u prezantua me një fakt të tillë. Është e dukshme se kjo e cënon procedurën dhe është shkak që të konstatohet një shkelje e tillë. Gjithashtu ndjejmë nevojën tju rikujtojmë se në situata analoge shoqëria Gjeokonsult& Co është përjashtuar nga një tjetër autoritet kontraktor kur nuk ka aplikuar në dokumente të noterizuara dhe për këtë nuk është marrë në konsideratë asnjë ankesë nga ana jonë për të rikuperuar këtë gabim të bërë nga ana jonë. Duhet të sjellim në vëmendjen tuaj faktin se detyrimi për të noterizuar dokumentat buron nga parimi i përgjithshëm i siurisë juridike që i duhet krijuar çdo subjekti të së drejtës duke kuptuar kështu që vërtetësia e dokumentave që dorëzohen mund të verifikohet vetëm nëpërmjet këtij mekanizimi ligjor që ka vendosur ligji. Kjo është një formë e konkurrencës së ndershme e transparencës që shoqëron të gjithë frymën e këtyre lloj procedurave dhe normalisht në kuadër të parimit të meritokracisë të mund të kualifikohet subjekti që mund të përmbushë objektin e kontratës. Prandaj do të ishte me vend që të konstatohej kjo shkelje sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mund të skualifikohet BOE Infra Plan JV Archistudio.
- Gjithashtu mungesa e shtojcës 3 ose Formulari i Deklarimit të Propozimit në të gjitha rastet ka qenë shkak për skualifikim edhe pse jemi ankuar për të rikuperuar këtë qëndrim sërish nuk ka ndryshuar vendimarrja. Në raste analoge shoqëria Archispace shpk është përjashtuar nga tenderi për mungesë të këtij formulari duke bërë të qartë se është kriter skualifikues. Mbajtja e dy standarteve ul besueshmërinë dhe transparencën gjë e cila vë në diskutim të gjithë rezultatin e kësaj procedure.
- Së dyti ndër të tjera gjatë verifikimit të shoqërive që kanë kaluar këtë fazë stafi jonë bëri verifikimet përkatëse dhe na rezulton që BOE Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk kanë një problem me njërin nga shoqëritë e bashkuara. Konkretisht shoqëria Thymio Papayannis and Associates rezulton në ekstraktin e saj e pezulluar. Ky është një verifikim lehtësisht i mundur ku me platformën online mund të verifikohet nga

secili dhe do të vihet re ky përfundim i nxjerë nga ana jonë. Duke qenë se është një subjekt i regjistruar në RSH do ti nënshtrohet kushteve dhe kriterëve që ligji jonë parashikon për këtë rast që do të thotë që për të marrë pjesë në një procedurë tenderi si dhe në të tjera veprimtari personi juridik duhet të ketë personalitet juridik. Këtë të fundit personi juridik ndryshe nga personi fizik e fiton me regjistrimin e tij në QKB dhe me mundësinë aktive të tij, pra nuk mund të jetë në qarkullim tregëtar, të futet në marrëdhënie juridike, të marrë përsipër të drejta dhe detyrime kur nuk ka personalitet juridik ose kur këtë e ka të pezulluar. Këtu lind pyetja se ky subjekt duhet të ishte verifikuar që tek zyra e noterisë ku ka bërë marrëveshjen për BOE dhe normalisht edhe kjo marrëveshje është pjesërisht e pavlefshme pasi ka shprehur vullnetin një subjekt i cili nuk mundet ligjërisht të sjellë pasoja juridike kur nuk plotëson një ndër kushtet sine quo non të zotësisë për të vepruar të subjektit të së drejtës në këtë marrëveshje.

- Ndër të tjera licencat e këtij subjekti duhet të jenë të konvertuara sipas sistemit tonë të njohjes së licencave dhe të velrësuar sipas mënyrës që legjislacioni jonë ka përcaktuar konkretisht ky subjekt nuk përmbush edhe një detyrim tjetër thelbësor të parashikuar në VKM 914 ku në nenin 38 të tij kërkohet që shoqëritë e huaja të kenë të konvertuar licencat sipas sistemit tonë dhe të jenë të njohura këtu në Shqipëri sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. Kjo do të thotë që duhet të krijohet lidhja e shoqërisë që ekziston në vendin e origjinës me shoqërinë që është pjesëmarrëse në këtë bashkim operatorësh për të verifikuar mundësinë që kanë formimin e duhur për të kryer objektin e kontratës që tenderohet. Në këto kushte këto shkelje janë thelbësore dhe është me ven që të verifikohen dhe të konstatohen dhe nga ana juaj pohimet tona.
- Duke qenë se një nga operatorët e BOE Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk konkretisht Thymio Papayannis and Associates rezulton me status pasiv cka do të thotë që nuk disponon licencë profesionale valide në Shqipëri kërkohet nga ana juaj skualifikimin e këtij BOE.
- Të nderuar anëtarë po sjellim në vëmendjen tuaj se reagimi jonë vjen për të patur një konkurim të drejtë dhe me pjesëmarrës të denjë ligjërisht të paktën që është kusht thelbësor që duhet të përmbushet para se të kalojmë në kushte të tjera të përcaktuara nga DT.

II.6. Në datën 10.04.2020, nëpërmjet shkresës me nr.756/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë:

- Në datën 01.04.2020 referuar ftesave dhe njoftimeve për dorëzimin e propozimeve teknike në selinë e FSHZH në prezencë të përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë dhe komisionit të vlerësimit të ofertave u hap procedura e pranimit dhe hapja e propozimit teknik.
- Procesi i hapjes është regjistruar në procesverbalin datë 01.04.2020 dhe u firmos nga të gjithë përfaqësuesit e operatorëve pjesëmarrës të cilët nuk patën pretendime apo

kundërshtime në lidhje me zhvillimin e procesit si dhe u dirmos nga anëtarët e komisionit. Aktualisht komisioni është duke shqyrtuar propozimet teknike.

- *FSHZH ju sjell në vëmendje nenin 63 pika 1 dhe 2 të LPP i ndryshuar në të cilën është parashikuar: Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*
- *Më tej në nenin 37 pika 4 në shkronjën ë/ii të VKM nr.914/2014 parashikohet shprehimisht : Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim. Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti kontraktornjofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim dhe i kthen të pahapura propozimet ekonomike. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.*
- *Sa në sipër FSHZH gjykon se ankesa e dorëzuar nga BOE Gjeokosult&Co shpk&Archispace shpk nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga elementët e domosdoshëm të ankesës ndaj përbën shkak për mosmarrjen në shqyrtim të ankesës nga ana e FSHZH për shkak të mosrespektimit të afateve për ankim.*

II.7. Në datën 17.04.2020 BOE ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 852/1 prot., datë 29.04.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.352/2 datë 29.04.2020 , me objekt “*Dërgim informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Vlen të sqarojmë se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit gjykoi se ankimuesi, prima facie ka respektuar kushtet formale dhe vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar në lidhje me respektimin e kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pa i hyrë në thelb shqyrtimit të pretendimeve të tij, për faktin se respektimi i kushteve formale, dhe konkretisht në lidhje me afatet e ankimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk ishin shumë të qarta vetëm nga dokumentacioni i paraqitur prej tij në depozitimin e ankesës.

Pas shqyrtimit, verifikimit e ballafaqimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton si më poshtë:

III.1.1. Në datën 28.01.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Shërbim Konsulencë*”, me nr.REF-48358-01-28-2020 me objekt “*Projektim, për rikualifikimin e Zonës Bregdetare Vlorë - Radhimë - Orikum, Loti III*”, me fond limit 53,943,848 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr.852/1 datë 29.04.2020 rezulton se në datën 20.02.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk
- BOE Seed Consulting shpk& Kejsi-05 shpk& “Atelier 4” shpk

III.1.3. Në datën 02.03.2020 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në fazën e parë, nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk
- BOE Seed Consulting shpk& Kejsi-05 shpk& “Atelier 4” shpk

III.1.4. Në datën 01.04.2020 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike ku kanë marrë pjesë ofertuesit si më poshtë:

- BOE Gjeokonsult&Co shpk&Archispace shpk
- BOE Technical Planning&Development shpk& Thymio Papayannis and Associates& HMK Consulting shpk
- BOE Infra Plan shpk& Archstudio shpk

III.1.5. Në datën 07.04.2020 BOE “Gjeokonsult&Co” shpk& “Archispace” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar skualifikimin e BOE Infra Plan & Archstudio” shpk dhe “Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk , me argumentat *Së pari në DT e publikuara nga FSHZH një ndër kriteret kryesore të cilat kanë të bëjnë me dokumentacionin është kushti që dokumentat duhet të jenë të noterizuara. Nga konstatimi direkt i përfaqësuesit tonë në hapjen e zarfave është vënë re se dokumentat e BOE Infra Plan JV Archstudio nuk janë të noterizuar. Si dhe në procesverbal nga analiza e të gjithë subjekteve pjesmarrës rezulton se për të gjitha shoqëritë e tjera është e shkruar kur kanë depozituar dokumente të noterizuar ndërsa konkretisht te kjo shoqëri nuk është cituar një gjë e tillë pasi në të vërtetë nuk i ka patur të noterizuar . Ky fakt duhet të kishte bërë shkak për skualifikim dhe nuk duhet të vije më tej ky bashkim operatorësh.*

Në VKM nr 914 i ndryshuar konkretisht në nenin 57 personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit është e parashikuar shumë qartë detyrimi i kësaj strukture për të kërkuar dokumente origjinalë ose kopje të noterizuar si dhe për rrjedhojë këtë detyrim duhet ta përmbushin operatorët të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë. Ky është një shkak thelbësor dhe që normalisht duhet të ishte evidentuar që në momentin e parë që njësia e prokurimit publik u prezantua me një fakt të tillë. Është e dukshme se kjo e cënon procedurën dhe është shkak që të konstatohet një shkelje e tillë. Gjithashtu ndjejmë nevojën tju rikujtojmë se në situata analoge shoqëria Gjeokonsult& Co është përjashtuar nga një tjetër autoritet kontraktor kur nuk ka aplikuar në dokumente të noterizuara dhe për këtë nuk është marrë në konsideratë asnjë ankesë nga ana jonë për të rikuperuar këtë gabim të bërë nga ana jonë. Duhet të sjellim në vëmendjen tuaj faktin se detyrimi për të noterizuar dokumentat buron nga parimi i përgjithshëm i siurisë juridike që i duhet krijuar cdo subjekti të së drejtës duke kuptuar kështu që vërtetësia e dokumentave që dorëzohen mund të verifikohet vetëm nëpërmjet këtij mekanizimi ligjor që ka vendosur ligji. Kjo është një formë e konkurrencës së ndershme e transparencës që shoqëron të gjithë frymën e këtyre lloj procedurave dhe normalisht në kuadër të parimit të meritokracisë të mund të kualifikohet subjekti që mund të përmbushë objektin e kontratës. Prandaj do të ishte me vend që të konstatohej kjo shkelje sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mund të skualifikohet BOE Infra Plan JV Archstudio.

Gjithashtu mungesa e shtojcës 3 ose Formulari i Deklarimit të Propozimit në të gjitha rastet ka qenë shkak për skualifikim edhe pse jemi ankuar për të rikuperuar këtë qëndrim sërish nuk ka ndryshuar vendimarrja. Në raste analoge shoqëria Archispace shpk është përjashtuar nga tenderi për mungesë të këtij formulari duke bërë të qartë se është kriter skualifikues. Mbajtja e dy standarteve ul besueshmërinë dhe transparencën gjë e cila vë në diskutim të gjithë rezultatin e kësaj procedure.

Së dyti ndër të tjera gjatë verifikimit të shoqërive që kanë kaluar këtë fazë stafi jonë bëri verifikimet përkatëse dhe na rezulton që BOE Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk kanë një problem me njërin nga shoqëritë e bashkuara. Konkretisht shoqëria Thymio Papayannis and Associates rezulton në ekstraktin e saj e pezulluar. Ky është një verifikim lehtësisht i mundur ku me platformën online mund të verifikohet nga secili dhe do të vihet re ky përfundim i nxjerë nga ana jonë. Duke qenë se është një subjekt i regjistruar në RSH do ti nënshtrohet kushteve dhe kriterëve që ligji jonë parashikon për këtë rast që do të thotë që për të marrë pjesë në një procedurë tenderi si dhe në të tjera veprimtari personi juridik duhet të ketë personalitet juridik. Këtë të fundit personi juridik ndryshe nga personi fizik e fiton me regjistrimin e tij në QKB dhe me mundësinë aktive të tij, pra nuk mund të jetë në qarkullim tregëtar, të futet në marrëdhënie juridike, të marrë përsipër të drejta dhe detyrime kur nuk ka personalitet juridik ose kur këtë e ka të pezulluar. Këtu lind pyetja se ky subjekt duhet të ishte verifikuar që tek zyra e noterisë ku ka bërë marrëveshjen për BOE dhe normalisht edhe kjo marrëveshje është pjesërisht e pavlefshme pasi ka shprehur vullnetin një subjekt i cili nuk mundet ligjërisht të sjellë pasoja juridike kur nuk plotëson një ndër kushtet sine quo non të zotësisë për të vepruar të subjektit të së drejtës në këtë marrëveshje.

Ndër të tjera licencat e këtij subjekti duhet të jenë të konvertuara sipas sistemit tonë të njohjes së licencave dhe të velrësuar sipas mënyrës që legjislacioni jonë ka përcaktuar konkretisht ky subjekt nuk përmbush edhe një detyrim tjetër thelbësor të parashikuar në VKM 914 ku në nenin 38 të tij kërkohet që shoqëritë e huaja të kenë të konvertuar licencat sipas sistemit tonë dhe të jenë të njohura këtu në Shqipëri sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. Kjo do të thotë që duhet të krijohet lidhja e shoqërisë që ekziston në vendin e origjinës me shoqërinë që është pjesëmarrëse në këtë bashkim operatorësh për të verifikuar mundësinë që kanë formimin e duhur për të kryer objektin e kontratës që tenderohet. Në këto kushte këto shkelje janë thelbësore dhe është me ven që të verifikohen dhe të konstatohen dhe nga ana juaj pohimet tona.

Duke qenë se një nga operatorët e BOE Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk konkretisht Thymio Papayannis and Associates rezulton me status pasiv cka do të thotë që nuk disponon licencë profesionale valide në Shqipëri kërkojmë nga ana juaj skualifikimin e këtij BOE.

Të nderuar anëtarë po sjellim në vëmendjen tuaj se reagimi jonë vjen për të patur një konkurim të drejtë dhe me pjesëmarrës të denjë ligjërisht të paktën që është kusht thelbësor që duhet të përmbushet para se të kalojmë në kushte të tjera të përcaktuara nga DT.

III.1.6. Në datën 10.04.2020, nëpërmjet shkresës me nr.756/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës me argumentat se ankesa është paraqitur jashtë afateve të lejuara ligjore.

III.1.7. Në datën 17.04.2020 BOE ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

III.1.8. Sa më sipër parashtruar, KPP sjell në vëmendje nenin 3, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë”*.

III.1.9. Në nenin 37 “Shërbimet e konsulencës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP-së, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.*

ii. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
- përvojën e konsulentit; - cilësinë e metodologjisë së propozuar; - kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; - transferimin e njohurive, nëse kërkohet. *“Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar”*.

Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 e, më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

“Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij”.50

Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti kontraktornjofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim dhe i kthen të pahapura propozimet ekonomike. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.

III.1.10. Neni 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikon shprehimisht se : *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit*

kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.11. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;*
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;*
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;*
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.*

III.1.12. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së). KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor.

III.1.13. Referuar sa më sipër, KPP vëren se në datën 02.03.2020 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në fazën e parë. Ndërsa faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor është

zhvilluar më datë 01.04.2020 dhe ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i propozimeve teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesmarrës.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të ngritura nga BOE Gjeokonsult&Co” shpk& “Archispace shpk KPP vëren se ndërsa për BOE Infra Plan shpk & Archstudio shpk ngrihen pretendime se në datën e hapjes së propozimeve teknike nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit në formë të noterizuar dhe Formulari i Deklarimit të Propozimit, për BOE Infra Plan & Archstudio” shpk dhe “Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk, janë ngritur pretendime lidhur me subjektin Thymio Papayannis and Associates për shkak të statusit pasiv të tij në certifikatën e regjistrimit si dhe mungesën e licencave të vlefshme në RSH.

III.1.14. KPP sqaron se procedura e konsulencës si një procedurë e ndarë në faza njeh dy momente në kuptim të nenit 63 të LPP në të cilat operatorët ekonomikë pjesmarrës mund të legjitimohen të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit për shkak se u janë cënuar ose mund tu cënohen të drejtat e tyre të pjesmarrjes.

Së pari është në fazën e klasifikimit të parë të operatorëve ekonomikë nga autoriteti kontraktor (short listing) , pra pas shprehjes së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës dhe pasi autoriteti kontraktor ka marrë një vendim lidhur me klasifikimin e tyre për të vijuar me fazën tjetër të procedurës.

Së dyti legjitimohet kërkuesi për të ushtruar të drejtën e ankimit pas përfundimit të shqyrtimit të propozimeve teknike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës nga autoriteti kontraktor dhe marrjes dijeni për klasifikimin përfundimtar të tyre. Nuk ka asnjë vendim të ndërmjetëm përveç se një vendimi përfundimtar të autoritetit kontraktor i cili ka cënuar të drejtat e operatorëve ekonomikë pjesmarrës i cili mund të bëhet objekt ankimi. Dhe ne rastin konkret procesverbali i datës 01.04.2020 të cilin ankimuesi e kundërshton nuk është gjë tjetër vecse njëj akt i ndërmjetëm i autoritetit kontraktor për marrjen në dorëzim të propozimeve teknike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës që kanë kaluar fazën e parë, dhe nuk mund të konsiderohet si një vendim përfundimtar i autoritetit kontraktor lidhur me statusin e operatorëve ekonomikë.

III.1.15. Në rastin konkret KPP referuar parashtrimeve në ankesë nga BOE si dhe informacionit të autoritetit kontraktor vëren se procedura e prokurimit objekt ankimi është ende në fazën e shqyrtimit nga ana e KVO të propozimeve teknike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës dhe ende nuk është marrë një vendim konkret nga autoriteti kontraktor lidhur me klasifikimin përfundimtar të operatorëve. Rezulton e provuar gjithashtu se në datën 01.04.2020 nga KVO janë marrë në dorëzim propozimet teknike dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe autoriteti kontraktor ka marrë kohën e nevojshme të parashikuar në ligj nga momenti i dorëzimit të propozimeve teknike për të marrë një vendimarrje lidhur me kualifikimin/skualifikimin e operatorëve.

Në këto kushte KPP gjykon se përderisa ende nuk ka një vendimarrje nga autoriteti kontraktor pasi nuk ka një klasifikim përfundimtar në lidhje me statusin e operatorëve ekonomikë pjesmarrës për fazën e dytë të procedurës, BOE ankimues nuk ka një vendim konkret të autoritetit kontraktor që e legjitimon atë të ngrejë pretendime kundër tij për

shkak se i ka cënuar një të drejtë në kuptim të nenit 63 të sipërcituar. Nga shqyrtimi në tërësi i pretendimeve të palës ankimuese nuk rezulton e provuar se bashkimi i operatorëve ekonomikë është cënuar nga veprimet e autoritetit kontraktor pasi procedura është ende në zhvillim.

III.1.16. Në përfundim , KPP gjykon se pretendimi BOE ankimues lidhur me statusin pasiv si dhe mungesën e licencave të anëtarit të bashkimit “Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk, Thymio Papayannis and Associates” ka të bëjë pikërisht me fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi dokumenti i regjistrimit dhe licencat përkatëse janë dokumentacion që kërkohen të paraqiten që në këtë fazë. Në këtë kuptim pretendimet e BOE ankimues lidhur me përjashtimin e BOE Technical Planning” & “Development” shpk, “Thymio Papayannis and Associates” & “HMK Consulting” shpk, janë në tejkalim të afateve ligjore marrë parasysh që klasifikimi i operatorëve për fazën e parë është kryer më datë 02.03.2020.

Ndrërsa sa i takon pretendimeve të BOE ankimues për skualifikimin e BOE Infra Plan shpk & Archstudio shpk, KPP gjykon se nuk mund të shprehet në lidhje me të pasi shqyrtimi i propozimeve teknike nuk ka përfunduar ende së pari në autoritetin kontraktor, pra nuk ka një vendim të autoritetit që cënon të drejtën e ankimuesit për sa kohë që në datën 01.04.2020 nuk është bërë shqyrtimi i propozimeve teknike sikundër del nga informacioni i autoritetit kontraktor, por thjesht marrja në dorëzim e propozimeve teknike , dhe autoriteti kontraktor ka njoftuar se do marrë kohën e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

III.1.17. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.*

III.1.18. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.*

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE Gjeokonsult&Co” shpk& “Archispace” shpk për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me nr.REF-48358-01-28-2020 me objekt “Projektim, për rikualifikimin e Zonës Bregdetare Vlorë - Radhimë - Orikum, Loti III”, me fond limit 53,943,848 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 01.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 352 Protokoli, Datë 17.04.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha